



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Kamëz, më 20.11.2024

Nr. 156 prot.

V E N D I M
Nr. 115. Datë 20/11/2024
MBI

“MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË
STREHIMIT “SUBVENCIONI I QIRASË”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 20.11.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.88 Datë 15.11.2024 në mbështetje të Ligjit Nr 139 datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", Ligjit Nr 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile"; Ligji nr.22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar; Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM nr.362 datë 20.05.2019 "Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij"; VKM nr. 459 datë 03.09.2019 "Rregullat për administrimin e kërkesave të njësisve qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe ministrisë përgjegjëse për strehim"; VKB nr.141 datë 25.11.2022 "Mbi miratimin e manualit për procedurat lidhur me Subvencionimin e Qirasë për vitin 2024"; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr. 1043 prot, datë 07/11/2024 "Ngritjen e Grupit të punës për ndjekjen dhe trajtimin të individëve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lire brenda territorit të Bashkisë Kamëz , Këshilli Bashkiak Kamëz";

V E N D O S I:

1. Miratimin e manualit lidhur me procedurat për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të individëve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë për vitin 2025.
2. Shfuqizimin e Vendimit nr.141 atë 25.11.2022 "Për miratimin e manualit të subvencionit të qirasë për vitin 2023".
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me nr. prot, 1043 datë 07/11/2024 "Për pranimin e kërkesave dhe administrimin e dokumentacionit të aplikanteve që kanë aplikuar për të përfutuar nga programi "Subvencionimi qirasë" për vitin 2025.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

4. Ngarkohet për zbatim Drejtoria Emergjencave Civile dhe Strehimit dhe Drejtoria Financës dhe Kontabilitetit.

Manuali për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të individëve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në Bashkinë Kamëz për vitin 2025, paraqitet bashkëlidhur këtij vendimi.

- 5 . Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI